

28.01.2025

Proces-Verbal i mbajtur sotë më datë 28.01.2025, ora 13:00 min, në sallën e mbledhjeve pranë Bashkisë Çerrik. Në mbledhje morin pjesë kryetori i Bashkisë E. Andis Solla dhe këshilltorët:

- |                     |                      |
|---------------------|----------------------|
| 1- Besnik Binjaku   | 11- Zegjine Dhepa    |
| 2- Erona Yjini      | 12- Ramil Boja       |
| 3- Jetmir Loshi     | 13- Madire Asthani   |
| 4- Zamira Fehriu    | 14- Elton Kumrija    |
| 5- Adriatik Belshi  | 15- Flutura Hoxholli |
| 6- Adli Gopa        | 16- Shyqyni Ahika    |
| 7- Burbuqe Rroja    | 17- Mandi Plaka      |
| 8- Elton Ibno       | 18- Shyqyni Kamoni   |
| 9- Pranvera Lici    | 19- Anisa Taci       |
| 10- Asqeri Xibtraku | 20- Gezmira Frakulli |
- Mungojnë :- Erinda Vishkulli.

Mbledhja kryesohet nga kryetori i këshillit Bashkiak i cili konstatoi se në mbledhje morin pjesë më shumë në gjysmë e këshilltorëve dhe këshilli i plot fuqishëm mund të vendos.

Rendi i ditës parashihet si më poshtë:

- 1- Pr/Vendim: "Për dhënie e ndihmës ekonomike nga fondi shtesë mbi fondin ekostëzuar për bllok-ndihmën (6%)".
- 2- Pr/Vendim: "Për dhënie e ndihmës ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për periudhën 1-31.12.2024".
- 3- Pr/Vendim: "Për miratimin e kriterëve specifike për familjet që do të trajtohen me 6% e fondeve të bllok-ndihmës për vitin 2025".
- 4- Pr/Vendim: "Për miratimin e kriterëve specifike për familjet që do të trajtohen me të ardhurat e Bashkisë për vitin 2025".
- 5- Pr/Vendim: "Për miratimin e ndihmës financiare për fëmijet me ofrësi ndryshe".
- 6- Pr/Vendim: "Për miratimin e ndihmës financiare për familjet në nevojë".
- 7- Pr/Vendim: "Marëveshjen e ambjentëve me qera për konkiktorët".

dhe shërbimin e mbrojtjes nga zjoni"  
 8-Pn/Vendim: "Kontrat qiraje mesatare"  
 9-Pn/Vendim: "Për mirëmbimin e 1-vlerave që përfitojnë familjet nga programi i shërbimit "Banesë sociale me qira (BSQ)", subvencionimi i qirave për vitin 2025. 2. Deklaratën e Kryetarit të Bashkisë për bashkëfinancimin në masën 20% të vlerës së projektit BSQ (Subvencionim qiraje) për familjet përfuturore"  
 10-Pn/Vendim: "Për mirëmbimin e 1-vlerave që përfitojnë individët/familjet nga programi i shërbimit "Përmirësimi i kushtet të banesave ekzistuese". 2. Deklaratën në Kryetarit të Bashkisë për bashkëfinancimin në masën 20% të projektit".  
 Kryesuesi: - Kush është dakort me rendin e ditës?  
 Miratohet rendi i ditës me:

20 vota Pro  
 0 vota Apstenim  
 0 vota Kundër

### Pika 1

Znj. Ornela Mehmeti, përgjegjëse pranë sektorit social i panoset këshillit Bashkiak ku i propozojnë drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social, të përfitojnë ndihmën ekonomike për muajin Dhjetor 2024, me 6% e fondit të Bllok-Mdhmës 38 familje me një fond prej 146.448 lekë. Paga të kryhet sipas listës emëtoare, që i bashkëlidhet kësaj projekti efi.

Kryesuesi: Pyetje dhe diskutime? S'ka

Miratohet me: 20 vota Pro  
 0 vota Kundër  
 0 vota Apstenim

### Pika 2

Znj. Ornela Mehmeti, i propozon këshillit Bashkiak të përfitojnë ndihmën ekonomike nga fondet e Bashkisë "Cemik", për muajin Dhjetor 2024, 45 familje me një fond prej 211.145 lekë. Ndajja sipas Kësajve Administrative sipas listës përkohëse. Ngarkohet Drejtoria e Financës, Juridike dhe Burimeve Njerëzore për zbatimin e kësaj projekti efi.

Pyetje dhe diskutime? S'ka?

Miratohet me:

20 vota Pro  
 0 vota Apstenim  
 0 vota Kundër

### Pika 3

Znj. Ornela Mehmeti propozon mirëmbimin e kriterëve specifike për familjet që do të përfitojnë Ndihmën Ekonomike me 6% e fondit të Kushtëzuesit të Bllok-Mdhmës për vitin 2025. Znj. Ornela përmend kriteret të detajuesha për këshillin. Disa nga kriteret janë:

- Përfshirja në skemën e 6% familjet të cilët janë shpallur me pikë të pa mjaftueshme nga sistemi ME dhe mbartin problematikat e mëposhtme social-ekonomike.
- Familjet në kushtet ekstreme varfërie
- Familje me fëmijë të vegjël të cilët jetojnë në kushtet të rënditura social-ekonomike.
- Familje të cilët kanë në përbërje të tyre kryefamiljoret gra efi.
- Familjet të cilët kanë në përbërje persona me probleme shëndetsore të cilët janë të paftë për të punuar.
- Familje të cilët mbartin problematika sociale.
- Familje të cilët i përkasin minoriteteve etnike dhe janë aliuar nga administratorët shoqërorë në kushtet të rënditura ekonomike.
- Familje me shumë fëmijë.
- Familje që kanë në përbërje të tyre antarë në moshë të madhe në pa mundësi për të punuar.
- Familje që kanë në përbërje antarë mbi moshë pune.
- Familje që kanë në përbërje një ose më shumë antarë që hapkin Universitetin.

Znj. Ornela shtoi se: - Për përfitim të Ndihmës nga 6% i fondit të Bllok-Mdhmës, familjet duhet të kenë aplikuar fillimisht në sistemin Elektronik të ME dhe duhet të kenë të plotësuar ulësimin social-ekonomik nga administratorët shoqërorë para përfshirjes në skemën e 6%.

Pyetje? Gozmira Fakulli: Si dalin nga sistemi

Kur janë në kushte ekstreme ?

Znj. Ornela: - I heq sistemi jo unë.

Miratohet me :

20 vota Pro

0 vota Kundër

0 vota Apstenim

Pika 4

Znj. Ornela rreton në lidhje me kriteret specifike për familjet që do të trajtohen me të adhurat e Bashkisë për vitin 2025. Znj. Ornela shtoi se kriteret e fondeve nuk ndryshojnë nga kriteret e 6%. Pasi Znj. Ornela diskutoi në lidhje me pikat në sallën e mbledhjeve filluan diskutimet.

Miratohet me :

18 vota Pro

0 vota Apstenim

2 vota Kundër

Pika 5

Z. Hekuran Kumria, Drejtori i financa i propozon kërkit të miratojnë projektin për miratimin e ndihmës financiare për fëmijet me aftësi ndryshe. Këtë muaj kemi shumë pak, deri tani na kanë ardhur 6 (gjyshtë) fëmijë kërkojnë që projektin të mbetet i hapur derisa të sjellin të gjithë familjerët letrat.

Znj. Enona Yjini: - kemi shumë fëmijë nëpër njësi të mbetet e hapur.

Z. Adriatik Belshi: - Kush është përgjegjës ?

Z. Hekuran: - Eshkë zyra e shërbimit të zyrës sociale.

Z. Adriatik: - Doja të flisja me specialistin për një qendër multifunksionale.

Z. Hekuran: - Janë shkollë të specializuara enkas. Për aq kohë sa nga shkollat nuk është ky shërbim.

Z. Andis Salla: - kemi datë fitues për të ngritur një qendër funksionale, është bërë për të gjithë shtresat. Diskutime në sallën e mbledhjes.

Miratohet me :

20 vota Pro

0 vota Apstenim

0 vota Kundër

Pika 6

Z. Hekuran i propozon këshillit bashkiak të miratojnë ndihmën financiare për familjet në nevojë. Z. Hekuran: - Për këtë muaj kemi dy familje të cilat janë me problematike të veçanta ekonomike shëndetsore të cilat janë:

1- Z. Ferdinand Mato në shumën 20000 lekë

2- Znj. Sonie e Zylfi në shumën 20000 lekë

Pyeqje dhe diskutime ? Ska

Miratohet me :

20 vota Pro

0 vota Apstenim

0 vota Kundër.

Pika 7.

Z. Hekuran Kumria, propozon të merret me qira mujore Objekte Funksionale që të përmbush kërkimet e më poshtme:

a) të siguroj ambjent të pranishëm për akomodimin e 12 konviktorëve (jo më pakë se 3 dhoma)

b) të siguroj ambjent për qatshinë dhe sall për ngrenie (Menc) për konviktorët.

c) të ketë ambjent të përshtatshëm për akomodimin, dhomin e godishmërisë si dhe magazinë për pajisjet e zjarrfikësore.

d) të ketë sheshe për parkimin e 3 Mjeteve të shërbimit për mbrojtjen nga zjarri.

2- Koha e kontraktit me qira, 6 muaj.

3- Kryetari i Bashkisë të ngriej një komision të posaçëm për gjekjen e ambienteve të përshtatshme brenda territorit të Bashkisë jo më shumë se 5 km nga Rezidenca e Bashkisë.

4- Komisioni të negocioj çmimin e qiras mujore.

5- Bashkia të lidh kontratat noteriale me qiradhënsin për kohë zgjedhjen dhe rlerën negociuar të qirasë mujore.

6- Shpenzimet do të mbulohen nga buxheti i Bashkisë

2025, i miratuar.  
 7 - Fondi i vënë në dispozicion 8000,000 lekë,  
 Pyetje dhe diskutime? S'ka  
 Miratohet me : 20 vota Pro  
 0 vota Kundën  
 0 vota Apstenim

Pika 8  
 Z. Hekuran Kumbia i propozon Këshillit Bashkiak të miratohet projekt - vendimin kontrakti Qirorje Financiare si më poshtë:  
 1- Të autorizojë Bashkinë Çmnik të negocioj marrjen e një Qirorje Financiare, me të drejtë blerje me pasë nga "Entsorgungsbetrieben Lubeck" e quajtur në vijim "EB2".  
 2- Objekti i Qirorje: Automjet vetëshktrruar 2998ccm/1129kw i pajisur me rinc.  
 3- Tipi i automjetit "Cater LFB / FE / FH / Euro 6 -  
 4- Vlera e Qirorje Financiare 3500000 lekë.  
 5- Koha e Qiramarrjes 36 muaj (3 vjet)  
 6- Vlera mujore e Qiror 70000 lekë  
 7- Pagosa nga buxheti i bashkisë Çmnik 2025, PBA 2025-2027, Programi 04520.1.291.

Pyetje dhe diskutime? S'ka  
 Miratohet me : 20 vota Pro  
 0 vota Apstenim  
 0 vota Kundën

Pika 9  
 Znj. Suzana Frakulli, punonjëse pranë Urbanistikës propozon të miratohet vlerën që përfitojnë individët/familjet nga subvencionimi i qirorje në drejtim të lirë për vitin 2025, lista mbyllet me nr 17 (shkëlqim mbledhjet) i individ/familje, dhe shuma totale që përfitojnë është 1539116 lekë (80% nga buxheti i shtetit në vlerën 1231293 lekë dhe 20% nga buxheti i bashkisë në masën 307823 lekë). 2- Të miratohet Deklaratën e Kryetarit të Bashkisë për Bashkëfinancim

në masën 20% të vlerës së projektit BSO për familjet përfituese.  
 Pyetje dhe diskutime? S'ka  
 Miratohet me : 20 vota Pro  
 0 vota Kundën  
 0 vota Apstenim

Pika 10  
 Znj. Suzana Frakulli i propozon Këshillit të miratohet: 1- Vlerat që përfitojnë individët/familjet nga programi: "Përmirësimi i bashkëveprimësive për komunitetet të varfëra dhe të pa favorizuara për vitin 2025. Lista mbyllet me nr. 19 (shkëlqim) shuma që përfitojnë individët/familjet është 21115099 lekë me drsh.  
 2- Deklarata e Kryetarit të Bashkisë për bashkëfinancim në masën 20% të projektit, në vlerën 4223020 lekë me drsh.

Pyetje dhe diskutime? S'ka  
 Miratohet me : 20 vota Pro  
 0 vota Kundën  
 0 vota Apstenim

Kryesuesi: - Duke ju falenderuar për pjesëmarrjen mbledhjen e deklarohet të përfunduar. Në këtë mbledhje u miratuan 10 (dhjetë) vendime. Mbledhja përfundoi në orën 15:45 min.  
 Sekretare e Këshillit Bashkiak Edije Asllani  
 Jetmir Karoshi

Besir Beqiri  
 Erona Gjini  
 Adnan Ziljani  
 Bujar Gashi